

BIBLIOTEKA  
SHTETIT

BSH-1

G 61

VJERSHA



# MAJI I ZAMBARËVE

RUZHDI GOLE

8SH-1  
961

RUZHDI GOLE

# MAJI I ZAMBAKËVE



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

## BETIM

Duke u përkulur mbi varrin e një partizani  
do të më gjeni në çdo 5 Maj,  
duke prekur kreshtën më të mprehtë,  
do të më gjeni në çdo 29 Nëntor,  
duke ndier zemrën e atdhetarëve  
do të më gjeni në të gjitha ditët,  
duke përqaftuar nënën time  
do të më gjeni në çdo mbrëmje,  
duke ecur me të dashurën  
do të më gjeni disa çaste,  
duke vigjëlur te kufijtë e atdheut  
do të më gjeni gjithë jetën.

## PËR ATDHEUN TIM

Atdheu është yni,  
që nga piramidat gjer te muranat tona,  
atdheu është yni,  
që nga gryka e tankut gjer tek autokombajnat,  
atdheu është yni,  
që nga dhembja e nënës gjer te foshnja që lind,  
atdheu është yni,  
që nga fëshfërima e barit gjer te perëndimi i diellit,  
atdheu është yni,  
që nga toka gjer në qiell, që nga toka gjer në det,  
sepse atdheu është prindi ynë  
dhe prindi s'i harron kurrë bijtë që ka lindur,  
sepse bijtë janë fytyra e vërtetë e tij  
dhe e shekullit që jetojmë.

## KUR IKI NGA VLORA

Me kokën të kthyer përgjysmë nga ti,  
me një pjesë zemre nëpër rrënjë ulliri,  
me një valë përplasur përmbi sup e gjoks  
me një puthje lënë ku flë Teli Ndini.

Sa zgjerohet deti, kur iki nga ti,  
sa skuqin gjethet, pjergullat e tua,  
sa shpejton era të arrijë tek unë  
të më sjellë pas fjalët që më thua.

Me kokën të kthyer përgjysmë nga ti,  
shkrirë zemër me zemër edhe sy më sy.

## PËR MINATORËT

Shpesh ata i merr malli për qiell të kaltër,  
gjer në mbasdite ai s'është në sytë e tyre,  
kur afrohen te tuneli ngrenë kokat lart,  
pesë minuta rrinë të heshtur në hyrje.

Me kasketat mbi krye largohen çdo mëngjes  
dikush nga nëna, nga motra, nga e dashura,  
s'e masin ata veten me peshën e rrogës,  
po me djersën që u kullon mbi shpatulla.

Uzinat tona moderne dhe Metalurgjia e Zezë  
kanë dalë dhe janë rritur nga kjo thellësi,  
zëri i minatorëve nis e oshëtin,  
që nga galeria e gjer në ministri.

Ata janë të heshtur. Tetë orë më këmbë  
poshtë peisazheve ngjyrë gri e të ashpër,  
që ne të mos na mungojë pushka dhe buka  
të mos na mungojë ky qiell i kaltër.

## EPIKË

Katër djem të bukur  
zambakë nga gjaku,  
ylber i këputur  
Mumini<sup>1)</sup> te pragu.

Hajredin Bylyshi  
shtrirë nën hardhi,  
sokëllimë mali  
dy buzët e tij.

Dega e hardhisë  
përmbys te pusi,  
është trupi i njomë  
i Hiqmet Buzit.

Flë gjokshapur  
Bajrami i skuqur,  
zambakë nga gjaku  
katër djem të bukur.

---

1) Heronj të Luftës Nacionalçlirimtare.

## PUNËTORËVE

Unë i vetëm s'mund ta ndërtoj një qytet  
sado i pashtershëm qofsha në krahët e mi,  
erërat që do frynin, shirat e pareshtur  
do të sillnin kujën tragjike të rrënimt të tij.

Kur ju vini duart tuaja mbi të  
sado shi të bjerë, sado erë të fryjë,  
do të përplasët, thyhet mbi forcën e shpatullave tuaja  
dhe në themelet e qytetit kurrë s'do të hyjë.



## DREJT VERIUT, DREJT VERIUT

Era bërtiti dhe vrapoi nga pyjet,  
ndërsa akujt shkrijnë mbi shpate dhe pemë,  
këtu të gjithë kanë ballin e malit Vermosh,  
këtu të gjithë flasin gjuhën e lumit Cem.

Pleqtë flasin për fushat nën një avull të ngrohtë,  
për bukën e parë që presin mbi tavolina,  
për vajzat që presin t'u kthehen nga universiteti,  
qiejt përcjellin dallëndyshet e fundit,  
të dashuruarit njëri-tjetrin.

Më afër i ndiej shokët,  
me shokët ngjitem gërxeve, me ta zbres udhëve,  
tani ne po rritemi dhe peshën e burrit e ndiejmë  
te thinjat,  
në dashurinë e sinqertë për fëmijët dhe nuset.

Era bërtiti dhe vrapoi nga bjeshkët  
mbi gjoksin tim dhe të malësorëve vërshëllen,  
këtu të gjithë kanë ballin e malit Vermosh,  
këtu të gjithë flasin gjuhën e lumit Cem.

## E PËRJETSHME

S'kishim bukë, po kishim plumba nga gjyshërit,  
na flisnin vikamat e tyre nga thellësitë e tokës,  
na flisnin muranat e tyre nën pjergullat e rruhit.

Po të qëlloni gurët e muranave të tyre me gishtërinjtë  
do dëgjoni sërish rrahjet e gjëmimit të gjyshërve,  
stuhitë do ndieni në gishtërinjtë tuaj,  
po të prekni rrotull fletët e luleve.

Balli i tyre i përplasur mbi shkëmb ka lënë një shenjë  
të përjetshme,  
është gjaku i tyre që jep gonxhen e një trëndafili  
të lulëzuar,  
ne do të ishim të vegjël pa këtë dhembje,  
pa këtë dashuri të pashuar.

## JEHONË

Ne në çdo pikë gjaku  
e duam jetën tonë dhe lirinë e saj,  
në çdo pikë gjaku  
një të ardhmë krijojmë, një fytyrë të re,  
askush s'mund t'i shkelë  
kufijtë e atdheut,  
kjo mund të ndodhë  
nëse vritemi të gjithë ne.

Oshëtima e kohës  
na ka krijuar gjymtyrët në shekuj  
dhe rreptësinë na ka krijuar  
thellë brenda vetes,  
tek ata që i falin gjakun  
dhe djersën të sotmes  
jeta ka forcën vigane të së nesërmes.

## NËSE MË KËRKONI

Rëndojnë gjatë ditëve, s'trokasim mbi asfalte  
tani këpucët e mia të mbushura me dhe.

Kur isha student, kam shkruar një vjershë për Tiranën,  
po shkruaj dhe këtë vjershë tani që s'ndodhem atje.

Bukuria është kudo: tek akulli i thyer mbi helmetën e  
ushtarit,  
te blegërimat e qengjave ndanë pishnajave të njoma,  
duke ecur bulevardeve ndanë qyteteve të mëdhenj  
kurrsesi s'do të harrojmë ku janë llogoret tona.

Nëse s'do të kalonim nëpër udhë ugaresh e lëndinash,  
s'do të mundnim të ngrinim uzina, as qytete të bukur,  
duart e mia para se të prekin fytyrën e së dashurës  
kanë prekur pushkën, kanë shtrënguar plugun.

Mua më gëzojnë antenat dhe grunjërat  
(siç gëzon mbrëmja çdo të dashuruar.)  
Nëse më kërkoni, kapërceni këto male  
për të më takuar.

## MIRËNJOHJE

Sa herë dëgjoj sirenat më afër të ndiej ty, qyteti im,  
brigjet e tu të moçëm e të thepisur nga mali në mal,  
ua morëm mermerin shkëmbenjve dhe e bëmë buste,  
shkumën e përrenjve e bëmë dritë në hidrocentral.

Oshëtimat e këngëve të tua më sjellin ndër mend detin,  
autokombajnat e tua më sjellin ndër mend grurin e tokës,  
vreshtat e tua më sjellin ndër mend mbledhëset  
e agrumeve,  
trenat më sjellin ndër mend të dashuruarit dhe shokët.

Kur flas për qiejt e tu të kaltër s'i kam harruar stuhitë  
sepse, duke dashur stuhitë, dua ushtarët që çajnë mes  
borës,  
kur flas për rrugët e tua, s'i kam harruar gërxhet  
e mprehta,  
sepse gërxhet më çojnë te sharrëxhinjtë dhe te minatorët.

Të gjithë bulevardet, teatrot dhe apartamentet  
kanë shkumën e përrenjve, që bie në hidrocentral,  
sa herë që vij dhe takoj shokët në qytet  
në gjoks kam erërat që fryjnë në mal.

## DËSHMORI

Mbete në çast shtrirë në gji të detit  
me një vijë gjaku përmes trupit tënd,  
duart e tua mbledhur grusht te gjoksi  
mbajnë mes gishtërinjve zemrën që dhemb.

Mos vesa e trëndafilave ta përgjaku ballin,  
gjerdanin e këputur që heshti në mëngjes  
këmishën që skuq nga supet gjer te gishtat,  
këmishën që skuq nga supet gjer në brez?!

Mbete përjetë shtrirë në gji të këngës,  
rri përmes ullinjve, pranë detit me valë,  
mal për ata që s'ta deshën vdekjen  
plumb për ata që të vranë.


## PËR LENININ

Qindra bronce janë derdhur dhe derdhen për Leninin,  
po Lenini mbi to kurrë s'ka për të fjetur,  
në të gjithë shekujt janë vetëtimat e tij,  
kurse vdekja e tij në asnjë shekull.



## KËNGË LABE PËR ZONJA ÇURREN

Brinja jote mbush' me plumba marrë krua më krua,  
era fryn porsi një fyell përmes brinjëve të tua,  
era të fryn përmes trupit, gjakun tënd prek e pi,  
syri të rëndon nën vetull, mali të rëndon në gji.  
Brinja jote mbush' me plumba marrë krua më krua,  
gjaku seç të rrodhi valë që nga balli gjer në thua,  
mali qau nën furtunë, fusha qau nën shi,  
ky flamur është gjoksi yt dhe kjo shkabë syr' i zi.



12403

## ZEMËRGJERËSI

Nga pyjet më të mira të krahinës sime  
të parët e mi kanë bërë djepe dhe daulle,  
daullet kanë pasur në gjënimet tragjike  
brofjen më këmbë të tyre.

Brofjen më këmbë ndoshta dhe nga vigu  
me një të prerë të gjakosur mbi supe,  
me thonjtë ngulur mbi shkëmben  
janë ngritur, kanë rënë, kanë ecur më tutje.

Kanë ecur mbi thepa me fatet e kombit  
kanë pasur një pishë, një djep, një varr,  
shpeshherë Lekën<sup>1)</sup> kanë marrë në mbrojtje —  
gabimi i tyre, i vetëm, fatal.

Dhe kur kanë qenë në çastet e fundit  
të parët e mi kanë bërë shqiponja  
për t'i vendosur në majat më të larta  
të kohëve dhe të viseve tona.

---

1) Është fjala për kanunin e Lekë Dukagjinit.

## REVOLUCIONI

Me duart e mia krijova shtyllën kurrizore të botës,  
duke i dhënë trajtat e shtatit tim të drejtë,  
kur prek tokat ndiej nën to vërshimet e lumenjve  
dhe vërshëllimat e baladave të popujve  
nën to kur i prek.

Erdha në botë i plagosur nga ciklonet që s'reshtin,  
duke thelluar shtratin tim përmes lugina malesh  
dhe përmes mijëra gjokse të vrara dëshmorësh,  
lënë mbi fatet e istikameve të tyre,  
mbi kreshtat e të pesë kontinenteve të botës.

Unë kurrë s'i harroj gjakderdhjet e damarëve të mi,  
/të popullit tim,  
sepse kurmet e të rënëve janë themeli dhe mosha e  
/lavdisë së Atdheut,  
tek unë dhe te zemërimi im,

në qoftë se ka diçka që dhemb, janë plagët që dhembin  
në qoftë se ka diçka që s'vdes, janë hakmarrjet që

/s'vdesin,

janë dhembjet dhe hakmarrjet që më japin pamposhtësinë.

Për mua, liria do të jetë graviteti i botës,

siç është ideali i saj

graviteti i trupit tim.

## POPULLI IM

Populli im,  
s'i kam harruar kurrë burrat e rënë ndanë brigjeve,  
/ndanë krojeve.

Në qoftë se ata u vranë dhe s'arritën deri te ne,  
s'harrojmë që plagët e tyre i kemi në kurmet tona  
të shndërruara në liri, krenari dhe dhembje,  
që kanë brenda pavdekësinë e tyre  
dhe lulëzimin tonë.

S'e kam harruar kurrë atë që u vra në kufi në ditën e  
/tij të dasmës,  
(Dantella e nuses i mbuloi plagët, duart,  
dhe ajo për herë të fundit, kur e puthi, sikur nga gjumi  
/e zgjoi,  
në buzët e skuqura të djalit, sikur çeli papritur një  
/degë me lule ftoi).

S'i kam harruar kurrë gratë shtatzëna që kanë lindur  
deri në vdekje  
dhe për herë të fundit kanë kënduar këngë,  
dhe për herë të fundit kanë tundur djepet.

(Ua dëgjojmë zërat në çdo belbëzim të fëmijëve,  
ku ato ripërsërisin për vetveten lindjen.)

Populli im.

Kanë fryrë shqota nga larg  
dhe është thërrmuar atje në shkëmbenjtë e bregut,  
atje ndanë fushave të mbjella me grurë,  
ndanë gjerësive me lumenj dhe maleve të lartë,  
nga ashpërsia është e vështirë të përcaktosh moshën  
te burrat,  
nga butësia është e vështirë të përcaktosh moshën te  
gratë.

Populli im,  
kam marrë shumë prej teje,  
jam pjesa jote  
pastaj e vetes.

## GJYSHI

Gjyshi im s'është më.

Nga dhembje dhe gëzimi sjellim njëri-tjetrin,  
nga të tjerët kemi ardhur, nga ne të tjerë do të vijnë,  
nën këta ullinj është deti  
nën to je ti, gjyshi im.

Prej stuhive ke lindur ti, gjyshi im,  
burrat dhe gratë, i gjithë brezi yt,  
ne njëri-tjetrin e njohim nga rrudhat,  
ne njëri-tjetrin e njohim nga sytë.

Te rrudhat kemi pasur vijat e shkëmbenjve,  
që kumbojnë po t'i prekësh sadopak me duar,  
te sytë-fushat pas lufte, pas dasme  
dhe perëndimin e diellit të pushuar.

Pranë teje gjithmonë unë nga dhembja kam heshtur,  
ose në kam qarë, nga dashuria për ty kam qarë,  
gjyshi im me një dorë prej shpate,  
që nga djepi gjer në varr.



## RAPSODI

### *Motiv i vjetër*

Klithën erërat dhe thanë emrin tënd.  
Të vranë në një natë vjeshte, të vranë.  
— Nuse, moj nuse, — thirrën nënat, —  
i kuq t'u bëftë fustani i bardhë.

Vajza e vogël doli netve,  
«Deti me dallgë qan nën ulli»  
— Vajzë, moj vajzë, — thirrën nënat, —  
më i zi t'u bëftë syri i zi.

Kthehu nga deti të puthësh gruan,  
të thanë njerëzit me zë legjende.  
— Unë në ditën e bukur të vjeshtës  
nuse mora plumb dhe vdekje.

Kthehu nga deti të rritësh vajzën!  
U thaftë deti, nga rrënjët u thaftë!  
— Mua në ditën e bukur të vjeshtës  
elegjia e nënave m'u bë vajzë.

## TE NJËRI-TJETRI

Shokët janë të ngjashëm si dy sy në një fytyrë rinore,  
që dridhen lehtë e lehtë para bukurive të njoma,  
te njëri-tjetri, duke pakësuar hidhërimet,  
duke pakësuar drojtjet  
prej dashurive tona.

Prej dashurive tona me shumë djersë e gjak,  
për të sjellë sa më afër njëri-tjetrin,  
për t'ua çuar atë njerëzve.

Kur flemë mbi akuj në një mesnatë marshimi,  
pasi jemi lodhur e heshtim të përmalluar,  
kur flemë mbi barin e sapokorrur në një mesditë vere,  
njëri-tjetrin te njëri-tjetri më shumë kemi shtuar.

## MJELËSJA

Ka mbrëmje që mjelësja kthehet vonë në shtëpi  
me gjinjte e gufuar nga aromat e fushës,  
kur gishtat e saj cikin fustanin  
spërkasin fustanin me qumësht.

Sa herë mjelësja është lodhur mes tyre  
tek to ka vënë faqen, përkulur kokën,  
e ndoshta mbi to ka lënë një puthje,  
ndoshta ka lënë fije nga flokët.

## PRINDËRIT E MI

Në rininë e tyre të munduar jam unë,  
tek unë — pasardhësit e familjes sime.  
të qytetit tim.

Ndiej se ullinjtë, zjarret dhe këngët e njëjta  
më bëjnë më të afërt, më të dashur me lebërit,  
më duket sikur nga isot e këngëve të tyre  
janë ngritur njëherësh të gjitha oshëtimat e detit.

Gjithë fëminia, rinia jonë 22-vjeçare,  
ka një dashuri të veçantë për tokën dhe barin,  
për shkollarët, punëtorët e pishat e bregdetit,  
që vazhdimësinë e kanë nëpër gryka mali.

## NGA NJË KTHIM

Kjo fushë është e pafundme kur ti pret dikë të dashur,  
kur di udhët nga shkoi dhe udhët nga do vijë.  
Në të pastë marrë rrahje gjoksi, kur iku,  
t'i sjell më të kumbueshme me gjoksin e tij.

Kjo fushë është e pafundme, kur ti pret dikë të dashur,  
që s'do t'i ndiej aq shumë supet e lodhura me borë,  
si qielli që s'e ndien shtrëngatën pas shtrëngatës  
dhe shfaqet për së dyti po aq madhështor.

## NDËR MËNGJESET E FUNDIT

Në çastet e ikjes këtu gjithçka më duket e shtrenjtë, që nga ndërtesat, lulishtet gjer te sheshi i qytetit, të nxituarit e orës 8 në udhën prej asfalti të gëzuarit e orës së fundit para fakultetit.

Këtu kam qenë dhe do të jem i pranishëm kudo te të gjithë stolat, te të gjitha dritaret, te sinqeriteti i të gjithë djemve çapkënë, te drojtja e ndershme e të gjitha vajzave.

Por s'trishtohem, në ikje lë pasardhës të tjerë, të cilëve u kam folur, u flas përzemërsisht, ngaqë e dua shumë këtë qytet të madh në të do të jetoj përjetësisht.

## DASHURIA

Hidhërimi s'është fytyra e Zef Srembes  
mbi varrin e së dashurës atje në Brazil,  
— Net të përmallura që më s'do ktheheni,  
jo mirupafshim, po lamtumirë! —

Pasuria e Srembes s'është kjo vajzë e humbur  
nga një udhëtim i largët me fyej shtrëngate,  
ai s'njohu kurrë një vajzë të dytë që ta deshte  
Zef Sremben martuar me vargjet...

Duke dashur të zbuloj një nga sekretet e jetës,  
poeti s'harroi vendlindjen që e priste në bregdet,  
dashuria i përket vetëm asaj,  
qoftë e lumtur, qoftë me dert.



## PIKTORIT V.MIO

E shoh Vangjush Mion mes peisazheve me mollët që  
lëkundin degët,  
mepërmes borës së Moravës ose në cipën e gjelbër  
të verës.

Gishtërinjtë e tij zgjaten nga përrenjtë, përrenjtë  
në këngën e barit,  
lindjeve na prekin — na prekin, perëndimeve rriten nga  
malli.  
Në fustanet popullore është bukuria e tij e pakrahasueshme,  
me ylberin e mbasdites të fshehur midis dy duarve.

## TIRANA

Tirana më lidh me rrugët e atdheut  
më lidh me adoleshencën dhe rininë time,  
nga qendra dhe peisazhet e periferive të saj  
kam marrë dhe kam lënë qindra sekonda intime.

I respektoj njëloj në këtë qytet të madh  
djemtë e ministrave, bujqve, karrocierëve,  
jam ulur me ta poltronave me damask  
kam ngritur me ta shtyllat e mermerëve.

Me shokët kam shkuar në «Drini» e Opera  
ashtu siç kam shkuar në shtigjet me borë,  
tani ata janë punëtorë, mësues,  
poetë të dëgjuar dhe ambasadorë.

Janë madhështorë të gjitha sheshet e Tiranës  
po aq madhështore sa dhe brigjet e rreptë,  
por një lumë s'do ta ndërronte kurrë emrin e tij  
duke braktisur tokën e shtratit të vet.

Kam mall për Tiranën në çastet e ndarjes,  
për vajzat e djemtë që njoha në shkollë,  
në lashë aty përrenj të pastër  
burimet e tyre i kisha në Vlorë.

## PËR VJESHTËN

Plepat ngjajnë si stacione të zhurmshëm  
tej periferive, ku zgjerohen kodrat,  
kudo lind, rritet dhe shpërthen vjeshta  
nga toka dhe era, nga oshëtima dhe limonat.

Na sjell zërin e asaj që na do, të asaj që e duam  
ose zërin e njohur të gruas dhe belbëzimet e fëmijëve,  
në vjershat e poetëve lë bukurinë e saj të pakraha-  
sueshme,  
tokave lë zemërgjerësinë e saj fisnike.

Kur të ikin ditët e fundit të vjeshtës,  
nën shirat stinorë dhe vetëtimat e largëta,  
djemtë do të kujtohen se janë bërë burra,  
vajzat do të kujtohen se janë bërë nëna.

## KUR JAM ME TY

Ne më të bukur bëhemi duke u dashuruar  
nën degët e agrumeve që na njohin në breg,  
dallga te dallga shkrihet, puthet,  
zemra te zemra njeh rrahjen e vet.

Unë e di se sytë e tu të mëdhenj e të bukur  
përjetë do të qeshin te të kaltrit sytë e mi,  
zemra sjell në buzë ato fjalë që ndien prej kohësh,  
deti sjell në breg atë ngjyrë që ka në thellësi.

\* \* \*

Vlora është shekuj pas shekujsh  
e shtyrë nga dallgët mbi fushë e breg,  
ullinjtë e saj kanë formën e shpatës  
ngritur nga kodrat përmbi det.

## PRANVERË

Është stina që i kërkojmë më shumë se kujtdo tjetër,  
që e kthen djersën dhe gëzimin në lule, bukë, fruta,  
nën qiellin e saj mbledhëset e agrumeve jugorë  
nesër do të kenë fejesat e dasmat e tyre të bukura.

Është stina që pret rritjen dhe pjekurinë e ditëve  
të ardhshme  
siç pret gruaja dikë t'i vijë e ta lehtësojë nga pesha  
e saj,  
të gëzohet për belbëzimet e pafajshme të fëmijës  
si rinia e fushave në prill ose në maj.

## AKOMA S'KA ZBARDHUR

Kush këndon?  
Përrenjtë që shkrihen ndër boriga  
apo fyejt e barinjve?!  
Kush e çau erën?  
Rrëmbimet e ujërave  
apo fluturimet e shqiponjave?!  
Ku ndodhen gjahtarët?  
Duke shkrepur çiftet  
apo rrotull zjarrit që shkrepëtin?!

S'mund të them i kujt është zëri  
i bariut apo i përroit,  
s'mund të them i kujt është gjoksi  
i shqiponjës apo i ujit,  
s'mund të them ku ndodhen gjahtarët.

Jam i sigurt se ushtarët janë te piramidat,  
që do të thotë  
se gruri është në pëllëmbën e secilit.

## DITË VERE ME SHI

Kur bari është i gjelbër delet kanë më shumë qumësht,  
kur qiejt janë të kaltër, më të ndritshëm janë dhe yjet,  
kur bujqit qeshin, më shumë grurë kanë fushat,  
kur zogjtë cicërojnë, më shumë pemë kanë pyjet.

Më zgjoi era ndër pisha dhe breshëri më zgjoi,  
u ngrita dhe vrapova te kullotat e deleve,  
u fola fshatarëve të korrin grurin,  
u fola zogjve të zbresin prej qiejve.



## RELIEV EPIK

Ky relief shqiptar i thyer dikur nga kryqet dhe varret  
ka rënduar me një fuqi vigane prej kohësh mbi to,  
mbi fushat e betejave dhe mbi sirenat e alarmeve  
ngrihen baladat e rrepta të kombit tim hero.

Ky relief shqiptar i rrëzuar diku mbi samarët e mu-  
shkave  
tani gulçon nga itineraret e avionëve, nga vinçat e  
hekurt,  
mbeti e pathyer mburoja e këtij vendi nga lufta në  
luftë,  
ndershmëria-ndershmëri nga shekulli në shekull.

Portat e Shqipërisë ngritur mbi gurët e kuq të kalave,  
kalldrëmët e saj bërë me gjak të ndritur dhe mermer,  
lidhur te dyfekët e gjithë shqiptarëve  
zë padridhur, krah paprerë.

## PRILL

Dëbora ka lënë gjurmët e saj te bardhësia e vijës ujit,  
qielli ka lënë shirat e tij te plisat e tokës.

Në se s'kthehem këtë mbrëmje, gjumi s'më ka marrë,  
ashtu siç nuk e merr vetmia e qetësisë rrëmbimin  
e ujërave,  
ashtu siç nuk e merr heshtja e mbrëmjes fluturimin  
e zogjve,  
ashtu siç nuk e merr ftohtësia e mjegullës kaltërsinë  
e qiellit  
në muajin prill dhe në muajt e korrjeve të mëvonshme.  
Përrenjtë e kulluar nga malet zgjuajnë frymëmarrjen te  
fushat

si mëngjesi te mbrëmja, ne te njëri-tjetri,  
dashuria ime e singertë për njerëzit dhe shqiponjat  
ka lindur njëkohësisht me dashurinë time për detin.

## KUR JAM LARG

Nën qiellin verior mendoja për ty,  
ndjeva se trokisnin mbi xhamat e lagur,  
në tingullin e tyre ishte shiu  
gishtërinjtë e tu ishin, e dashur!

Nën qiellin verior mendoja për ty  
ndjenjat tona s'u ndezën aq herët,  
po zjarri i vonë ngroh më shumë  
dhe mban më shumë se të tjerët.

Nën kreshtat veriore që mbrojnë qiellin  
pishtarët e tyre i ndezëm njëherë,  
jo me drurë të njomë e të thyer,  
jo në flakë të pishtarëve të tjerë.

Zjarri ynë qoftë i pashuar  
në thëllime dhe në ngrica,  
prushi i tyre të na bjerë  
përmbi gjoks e përmbi gishta.

## KUR BREGU ËSHTË I KALTËR

S'të iket nga bregu, kur është i kaltër  
gjer në mesnatë, as nga dashuria,  
të dashuruarit ngjasin midis tyre  
si ndjenjat e tua me ndjenjat e mia.

E dashur, ti çdo natë zbulon thellësitë e shpirtit,  
ashtu siç zbulon perlat e panjohura deti,  
pastaj i mbulon me shkumën e tij të bardhë,  
për të mos ia rrëmbyer në gjumë njerëzit.

Kur jam afër vreshtave, s'më iket nga ti,  
kur jam afër teje, s'më iket nga bregu,  
mendimet për ty më kanë bërë pak të thinjur,  
mendimet për ty më kanë bërë më të pjekur.

## PASQYRA E LËNDËS

Betim .....	3
Për atdheun tim .....	4
Kur iki nga Vlora .....	5
Për minatorët .....	6
Epikë .....	7
Punëtorëve .....	8
Drejt veriut, drejt veriut .....	9
E përjetshme .....	11
Jehonë .....	12
Nëse më kërkoni .....	13
Mirënjohje .....	14
Dëshmori .....	15
Për Leninin .....	16
Këngë labe për Zonja Çurren .....	17
Zemërgjerësi .....	18
Revolucioni .....	19
Populli im .....	21
Gjyshi .....	23
Rapsodi .....	25
Te njëri-tjetri .....	27
Mjelësja .....	28
Prindërit e mi .....	29
Nga një kthim .....	30
Ndër mëngjeset e fundit .....	31
Dashuria .....	32

Piktorit V. Mio .....	33
Tirana .....	34
Për vjeshtën .....	36
Kur jam me ty .....	37
Pranverë .....	38
Akoma s'ka zbardhur .....	39
Ditë vere me shi .....	40
Reliev epik .....	41
Prill... ..	42
Kur jam larg .....	43
Kur bregu është i kaltër .....	44

Tirazhi 1500 kopje

Format 70 x 100/32

Stash: 2204-72

---

KOMBINATI POLIGRAFIK — Shtypshkronja e Re

Tiranë, 1976